

PROCESVERBAL
nga seanca e 15-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 27.4.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivoli, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavllovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski (mungesë me arsye – pushim vjetor).

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Magdalena Davidovska- Dovleva, Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Vesna Simonovska, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 15-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Propozoi që pika 9 e Rendit të ditës, me titull "Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj NPR Makedonska Radiotelevizija Shkup - Televizioni i Maqedonis - Shërbimi i dytë programor (RTM2), për shkelje të nenit 48, paragrafi (2) të LShMAAV, të jetë pika 16, ndërsa pikat e mbetura në mënyrën përkatëse të rinumërohen, përkatësisht të zhvendosen një vend përpara.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjuar si mëposhtë:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 6-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 9.4.2026.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 9.4.2026.
3. Propozim-vedim për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurs të kufizuar në nivel lokal.
4. Propozim-vendim për anulimin e Vendimit që lejon ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR Radio Vat ShPK Shkup.

5. Kërkesë për pëlqim për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio paraqitur nga ShTR Radio Rosa-AB ShPKNJ P ShKUP, me Propozim-vendim.

6. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të ShTR Kompani 21-M ShPKNJ P Shkup, për shkelje të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

7. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të ShTR Kompani 21-M ShPKNJ P Shkup, për shkelje të nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 të LShMAAV.

8. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të ShTR Kompani 21-M ShPKNJ P Shkup, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.

9. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të DMTU-së në media dhe informacion Nistori ShPKNJ P fsh.Strumicë - Zhelinë, botues i medias online-internet portalit "Nistori", për shkelje të nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Median.

10. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të DITKU DMS Komunikacija ShPKNJ P Shkup, botues i medias online-internet portalit "Skopje Info", për shkelje të nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Mediat.

11. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të DMTU N&M Media Grupa ShPKNJ P Shkup, botues i medias online-internet portalit "Nacional", për shkelje të nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media.

12. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për pagesën e mjeteve për qasje në sistemin e shpërndarjes së internetit të Regjistrisë Qendror

13. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik - shërbime artizanale.

14. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim të furnizimit publik-shërbim: mirëmbajtja e softuerit për sistemin e monitorimit të shërbimeve televizive dhe radio të ORRPKE.

15. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim të furnizimit publik-shërbim: mirëmbajtja e higjienës në ambientet e punës së Agjencisë.

16. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të Ndërmarrjes Publike Radiotelevizive Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i dytë programor (RTM2), për shkelje të nenit 48, paragrafi (2) të LShMAAV.

17. Të ndryshme

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 6-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 9.4.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 9.4.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska shpjegoi se më 27 shkurt 2026 drejtuar Agjencisë u dorëzua Kërkesë për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedone, në nivel lokal në zonën e Komunës së Prilepit. Pas pranimit të Kërkesës, të gjithë sektorët e shërbimit profesional të Agjencisë e shqyrtuan dhe konstatuan se ishte e plotësuar në rregull dhe përmban të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 76, paragrafët (3) dhe (4) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Në bazë të analizës së kryer të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe verifikimeve plotësuese në lidhje me lidhshmërinë e mundshme të subjekteve dhe strukturën pronësore në media, u konstatua se Kërkesa është e rregullt, prandaj Drejtori i paraqiti propozim Këshillit për miratimin e vendimit për dhënien e lejes për transmetim televiziv përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurs të kufizuar, në nivel lokal.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli shtroj pyetje në lidhje me Pikën 8 të Konceptit programor për shërbimin programor televiziv, përkatësisht se në pjesën referuar përfaqësimit të veprave audiovizuele evropiane nuk është dhënë përgjigje, megjithëse, siç theksoi, ka njohuri se nuk ekziston detyrim.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi se kjo çështje nuk është relevante për transmetues në nivel lokal, prandaj nuk është dhënë përgjigje në Kërkesë.

Këshilltarja Vërzivolli plotësuese pyeti nëse për atë pjesë përgjigjja duhet të jetë "jo".

Emilija Janevska u përgjigj se formalisht duhet të shënohet, por se transmetuesi nuk kishte plotësuar asgjë, duke theksuar se kjo nuk paraqet problem, duke pasur parasysh se detyrimi për transmetimin e veprave audiovizuele evropiane sillet në veçanti për transmetuesit në nivel shtetëror.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, komunës së Dollnenit dhe komunës Krivogastani, personit Petar Georgieski nga Prilepi.

Shërbimi programor televiziv do të transmetohet nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurs të kufizuar.

Leja për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resur të kufizuar që jepet për periudhë prej 9 (nëntë) vitesh.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, detyrohet Vendimin e lartpërmendur ta publikon në uen-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi se Këshilli i Agjencisë paraprkakisht lejoi ndryshim të strukturës pronësore, por se pronari i ri i transmetuesit ShTR Radio VAT ShPK Shkup në afatin ligjor prej 90 ditësh nuk kishte kryer regjistrim në Regjistrin Qendror. Ai theksoi se, sipas komunikimit me pronarin e ri, arsytet e mosregjistrimit nuk rrjedhin nga faji i tij, por nga gjendjet e trashëguara nga pronari i mëparshëm, të cilat duhet të sqarohen me Ministrinë e Financave dhe Drejtorin e të hyrave publike.

Drejtori theksoi se, duke marrë parasysh se Ligji nuk parashikon mundësinë për vazhdimin e afatit prej 90 ditësh përcaktuar për zbatimin e ndryshimit në Regjistrin Qendror, propozohet që Këshilli të miratojë vendim që do të anulojë ndryshimin e lejuar më parë të strukturës pronësore. Plotësuese shpjegoi se pronari i ri, pas shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga gjendja e mëparshme, do të jetë në gjendje të paraqesë përsëri kërkesë për ndryshim të strukturës pronësore.

Këshilltarja mr. Zirjeta Jajaga, pyeti nëse, pas mënjanimit të të gjitha pengesave dhe heqjes së të gjitha pengesave dhe sqarimit të gjendjes në lidhje me pronarin e mëparshëm, kjo çështje mund të vihej përsëri në rend të ditës.

Drejtori Trajçevski u përgjigj se në këtë rast pronari i ri do të duhet të paraqesë kërkesë të re për ndryshim të strukturës pronësore, e cila përsëri do të ishte lëndë për shqyrtim nga Këshilli.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin anulohet në tërësi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr. 02-364 datë 15.1.2026, i cili lejon ndryshimin e strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Vat ShPK Shkup.

Vendimi me të cilin anulohet në tërësi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr. 02-364 datë 15.1.2026, i cili lejon ndryshimin e strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Vat ShPK Shkup, është përfundimtar dhe hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Të informohet Regjistri Qendror dhe Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Radio Vat ShPK Shkup se, në përputhje me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Vendimin PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026 anulohet, për shkak se ndryshimi i strukturës pronësore nuk është zbatuar brenda afatit ligjor prej 90 ditësh nga data e miratimit të Vendimit.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, detyrohet ta publikojë Vendimin e lartpërmendur në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 5

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, theksoi senë periudhën e kaluar, përkatësisht gjatë vitit të fundit të mandatit të përbërjes aktuale të Këshillit, janë evidentuar raste të kthimit të lejeve për transmetim nga disa transmetues, veçanërisht televizione dhe radio lokale, kryesisht për shkak të paqëndrueshmërisë ekonomike dhe pamundësisë për të mbijetuar në treg. Si shembull, ai përmendi rastin e fundit me transmetues nga Ohri. Në këtë drejtim, ai informoi se pronari i transmetuesit në fjalë ka paraqitur kërkesë për ndryshim të konceptit programor, me qëllim kalimin nga kryesisht folklorike popullore, përkatësisht muzikë

popullore, në format programor me muzikë kryesisht argëtuese. Siç theksoi, kërkesa është shpjeguar me qëllim përmirësimin e qëndrueshmërisë ekonomike të mediumit, duke siguruar numër më të madh reklamash dhe duke shmangur mbylljen e mundshme. Drejtori theksoi se Këshilli i Agjencisë ka mundësinë ligjore për të miratuar ndryshim të tillë në konceptin programor dhe vlerësoi se është e justifikuar t'u lejohet transmetuesve fleksibilitet në përcaktimin e strukturës programore, në mënyrë që të përshtaten më lehtë me kushtet e tregut dhe të plotësojnë nevojat e publikut. Ai gjithashtu theksoi se qasje e tillë është e rëndësishme edhe nga aspekti i ruajtjes së stabilitetit financiar të Agjencisë, duke pasur parasysh se transmetuesit paguajnë rregullisht taksat, që kontribuon në funksionimin e saj financiarisht të pavarur.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Kërkesën mbi pëlqimin për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio të ShTR Radio Rosa-AB ShPKNJ P Shkup dhe miratoi Vendim për dhënien e pëlqimit për ndryshimin dhe plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-74 datë 7.9.2023. të ShTR Radio Rosa-AB ShPKNJ P Shkup, në pjesën që lidhet me:

- Struktura e muzikës së transmetuar sipas zhanrit, përkatësisht në vend të 100% muzikë popullore maqedonase dhe zhanreve të ndryshme, të transmetohet 90% muzikë e zhanreve të ndryshme argëtuese dhe 10% muzikë popullore e zhanreve të ndryshme, dhe
- Struktura e muzikës sipas gjuhës, përkatësisht në vend të 100% në gjuhën maqedone, struktura e muzikës të jetë 87% në gjuhën angleze, 8% në gjuhën maqedone dhe 5% në gjuhë të tjera.

Vendimi që jep pëlqimin për ndryshimin dhe plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit është i detyruar Vendimin për dhënien e pëlqimit për ndryshime dhe plotësime në më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 6, 7 dhe 8

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se pikat 6, 7 dhe 8 të Rendit të ditës i referohen të njëjtit transmetues, ku dy pika rrjedhin nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dhe një nga Ligji për Mediat. Në këtë drejtim, ai propozoi që Emilija të japë sqarime në lidhje me të tre pikat, pas së cilës Këshilli do të hapë diskutim të veçantë dhe do të vazhdon me votim të veçantë për secilën pikë.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, MA, shpjegoi se tre shkeljet në ShTR TV Kompani 21-M u konstatuan gjatë mbikëqyrjes së rregullt të kryer në fillim të marsit 2026.

Shkelja e nenit 50, paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenit 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve ka të bëjë me respektimin e intervaleve kohore për transmetimin e kategorive të caktuara programore. Tek transmetuesi u konstatua se filmi artistik, i shënuar në mënyrë të përshtatshme me sinjalistikën paralajmëruese si program i kategorisë së tretë, është transmetuar në kohë të papërshtatshme, përkatësisht rreth orës 9:00 të mëngjesit, megjithëse sipas Rregullores ky program mund të transmetohet veçanërisht në periudhën nga ora 20:00 deri në orën 05:00.

Për këtë shkak propozohet shqiptimi i masës paralajmërimi publik, me afat për harmonizim prej 20 ditësh nga data e pranimit të aktvendimit, pas së cilës do të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Shkelja e dytë ka të bëjë me nenin 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 të Ligjit, përkatësisht i referohet rregullave për përdorimin e komunikimit komercial, përkatësisht plasim të produkteve. Konkretisht, kërkesat që programet në të cilat plasohen produkte nuk duhet të inkurajojnë drejtpërdrejt blerjen ose marrjen me qira të mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht përmes rekomandimit të tyre promovues, dhe të mos i japin rëndësi e tepruar produktit ose shërbimit në fjalë. Në rastin konkret, u konstatua se në dy ritransmetime të emisionit "Pastel" është kryer rekomandim promovues dhe iu dha rëndësi e tepruar produkteve nga "Zegin", veçanërisht pastilave "Flavo-Zinc" që është në kundërshtim me dispozitat ligjore që ndalojnë nxitjen e drejtpërdrejtë të blerjes ose marrjes me qira të mallrave dhe shërbimeve. Për transmetuesin dhe për këtë shkelje të konstatuar, propozohet shqiptimi i masës paralajmërimi publik, gjithashtu për këtë shkelje, në përputhje me Udhëzimin për afatin e harmonizimit është 20 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse do të veprojë sipas masës së shqiptuar.

Shkelja e fundit është për detyrimet administrative të Ligjit për Media, përkatësisht për detyrimin që në secilin program të transmetuar të publikohen të dhënat për impresium. Ditën që u krye mbikëqyrja, në dy edicione të emisionit "Pastel" nuk u publikun të dhënat për impresium. Për këto arsye, propozohet që për këtë shkelje të shqiptohet masë paralajmërimi publik me afat harmonizimi prej 20 ditësh, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Këshilltarja Afrona Vërzivoli shtroi drejtuar udhëheqëses së Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, nëse, pas mbikëqyrjes së kryer në fillim të marsit, transmetuesi kishte paraqitur arsyetim në Agjenci, përkatësisht nëse kishte detyrim ligjor për të paraqitur deklaram.

Udhëheqësja Janevska sqaroi se, pas konstatimit të ndonjë shkeljeje, Agjencia, në përputhje me dispozitat ligjore, paraqet kërkesë drejtuar transmetuesit për deklaram në lidhje me shkeljet e konstatuara, ku si shtojcë dorëzohet Raporti mbi mbikëqyrjen e kryer. Ajo shtoi se transmetuesit kanë mundësinë, por jo detyrimin, në afat prej 7 ditë pune të paraqesin deklaram. Në rastin konkret, informoi se nga transmetuesi nuk kanë mbëritur asnjë arsyetim ose deklaram..

Këshilltarja Cvetanka Minovska kërkoi sqarime shtesë nëse mosveprimi i referohet për tre shkeljet e konstatuara, për të cilat udhëheqësja Janevska u përgjigj pozitivisht, që do të thotë se nuk është paraqitur asnjë deklaram për asnjërën nga shkeljet.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, shtroi pyetje në lidhje me kriteret për përcaktimin e promovimit "të tepërt" të produktit, konkretisht nëse ekziston rregullore që definojnë saktësisht termat e tepërt, mesatarisht ose të ngjashme.

Udhëheqësja Janevska shpjegoi se ekziston Udhëzues për përdorimin e komunikimit komercial për plasim të produkteve, ku Pika 24 përcakton se vlerësimi nëse ka inkurajim të drejtpërdrejtë apo theksim të tepruar të produktit ose shërbimi kryhet nga rasti në rast, bazuar në disa kriteret. Si kriteret relevante, ajo renditi karakteristikat e plasimit (duke përfshirë hapësirën e ndarë për produktin në ekran ose në studio), kohëzgjatjen dhe frekuencën e përmendjes ose shfaqjes, përshtatshmërinë dhe justifikimin nga aspekti i konceptit editorial të programit, si dhe gjuhën dhe mjetet vizuale të përdorura. Ajo theksoi se, në rastin konkret, theksimi i tepruar u përcaktua bazuar në kontekstin e përgjithshëm, përkatësisht si përmes

shprehjes verbale të prezantuesve ashtu edhe përmes prezantimit vizual të produkteve nga sponsori "Zegin".

Këshilltarja Vërzivolli shtroi pyetje shtesë nëse në Udhëzim është përcaktuar pragu kohor (në sekonda) pas të cilit mund të vlerësohet se bëhet fjalë për reklamim të tepërt.

Udhëheqësja Janevska u përgjigj se nuk ka prag kohor të përcaktuar saktësisht, por se të gjithë elementët përkatës vlerësohen si një e tërë, në mënyrë që të përcaktohet nëse ka theksim të tepërt.

Lidhur me shembullin konkret, Këshilltarja Vërzivolli theksoi se deklarata e prezantueses zgjati rreth 40 sekonda, duke pyetur nëse kjo konsiderohej e tepërt.

Udhëheqësja Janevska sqaroi se gjatë vlerësimit është marrë në konsideratë i gjithë konteksti i emisionit, dhe jo vetëm kohëzgjatja e deklaratës, përkatësisht si aspekti vizual ashtu edhe ai verbal i përmbajtjes kanë kontribuar në përcaktimin e theksit të tepërt, ku në Udhëzim nuk është përcaktuar kohëzgjatje konkrete si kriter.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.10-1233/1 datë 19.3.2026 dhe njëzëri konkludoi që ShTR Kompani 21-M ShPKNJ P Shkup, t'i shqiptohet masë pralajmërim publik për shkelje të nenit 50, paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenit 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, sepse më 3 mars 2026, transmetoi filmin artistik "GI Jane (XHI-AJ XHEJN) të shënuar si program i kategorisë së tretë (12+), në periudhë kohore të papërshtatshme të ditës dhe natës.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar nr.01-4241/1 datë 1.10.2025), urdhërohet ShTR Kompani 21-M SHPKNJ Shkup, në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për ndërmarrjen e masës paralajmërim, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Spektori për çështje programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 7

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr. 10-1232/3 datë 3.4.2026 dhe njëzëri konkludoi që ShTR Kompani 21-M ShPKNJ P Shkup, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sepse më 3 mars 2026, në

ritransmetimet e emisionit të programin bisedë "Pastel", produktet e "Zegin" u rekomanduan në mënyrë promovuese dhe u kushtua rëndësi e tepruar (duke theksuar ose referuar).

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar nr.01-4241/1 datë 1.10.2025), ShTR kompani 21-M SHPKNJ Shkup urdhërohet që, në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për ndërmarrjen e masës paralajmërim, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektorei për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Sektori për çështje programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar të paralajmërimit publik (tërrësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrje të kryer administrative, nr.10-1231/1 datë 19.3.2026 dhe njëzëri konkludoi që ShTR Kompani 21-M ShPKNJ Shkup, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media, sepse më 3 mars 2026, në dy ritransmetime të emisionit të programit bisedë "Pastel", nuk i publikoi të dhënat që është e detyruar t'i transmetojë në vend të përshtatshëm për secilën përmbajtje të shërbimit programor.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar nr.01-4241/1 datë 1.10.2025), urdhërohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për ndërmarrjen e masës, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Mediat.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Sektori për çështje programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar të paralajmërimit publik (tërrësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar) pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendim ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 9

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit , Magdalena D. Dovleva, sqaroi se të tre subjektet me të cilat lidhen gjetjet janë botues të mediave online, përkatësisht portale të internetit. Ajo theksoi se ky është detyrim i përcaktuar në nenin 14 të Ligjit për Median, i cili i referohet publikimit impresium.

Lidhur me botuesin e medias online-internet portalit "Nistori" (www.nistori.mk), informoi se gjatë mbikëqyrjes së kryer është konstatuar se ekziston impresium, por ai nuk

përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara me Ligjin për Mediat. Në përputhje me detyrimet ligjore, botuesit i është dorëzuar raport me shkrim me kërkesë për deklaram. Ai sqaroi se nga ana e tyre nuk është dorëzuar asnjë njoftim me shkrim, megjithatë, menjëherë pas pranimit të raportit është bërë korrigjim në botim (impresium), i cili tani përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara ligjore.

Megjithatë, theksoi se konstatimi nga mbikëqyrja e kryer mbetet, prandaj propozohet shqiptimi i masës paralajmërim publik për shkeljen e përcaktuar në momentin e zbatimit të mbikëqyrjes në shkurt. Plotësuese theksoi se, nëse nuk ka ndryshime të reja në impresium, me mbikëqyrjen e kontrollit do të konstatohet se shkelja është mënjanuar.

Këshilltarja mr. Zirjeta Jajaga, duke iu referuar sa më sipër, kërkoi sqarime nëse është e nevojshme të shqiptohet masë paralajmërim publik në situatë ku mangësitë e konstatuara tashmë janë mënjanuar, përkatësisht kur botuesi ka vepruar sipas rekomandimeve të Agjencisë.

Udhëheqësja Dovleva u përgjigj se masa duhet të shqiptohet, duke marrë parasysh se në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes është konstatuar shkelja.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr. 03-777/1 datë 27.2.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për marketingut, tregti dhe shërbime në Media dhe informim Nistori ShPKNJ, fsh. Strimnicë - Zhelinë, botues i medias online-internet portalit "Nistori" (www.nistori.mk), t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për mospërmbushje të detyrimit të nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media, përkatësisht nuk ka publikuar të dhënat për: emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emrin dhe mbiemrin e kryeredaktorit, përkatësisht redaktorëve në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar nr.01-4241/1 datë 1.10.2025), urdhërohet që Shoqëria për marketing, tregti dhe shërbime në Media dhe informim Nistori ShPKNJ, fsh. Strimnicë - Zhelinë, botues i medias online-internet portalit "Nistori" (www.nistori.mk), në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit për ndërmarrjen e masës paralajmërim publik, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar të paralajmërimit publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk veproi), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 10

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, Magdalena D. Dovleva, informoi se tek botuesi i medias online- internet portalit "Skopje Info" shtë konstatuar gjithashtu se botimi i botuesit të portalit mediatik online "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk), Shoqëria për shërbime informacioni, teknike dhe konsulence DMS komunikim ShPKNJ

Shkup , u konstatua se impresium nuk i përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara në Ligjin për Media. Pas mbikëqyrjes së kryer, drejtuar botuesit i është dorëzuar raport me shkrim me kërkesë për deklaram, për të cilën ekziston prova e dorëzimit të rregullt. Ajo theksoi se botuesi nuk ka dorëzuar deklaram, dhe se, ndryshe nga nga rasti i mëparshëm, nuk ka vazhduar me korigjimin impresium. Gjithashtu, janë bërë përpjekje për të kontaktuar me telefon, por pa rezultat, dhe nuk është vërejtur asnjë ndryshim deri në ditën e seancës. Prandaj, pas shqiptimit të masës paralajmërim publik dhe pas pranimit të aktvendimit, botuesi do të jetë i detyruar ta harmonizojë impresium me dispozitat ligjore. Pas skadimit të afatit të përcaktuar, do të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse shkelja është mënjanuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr. 03-778/1 datë 27.2.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për shërbime informacioni, teknike dhe konsulence DMS Komunikim ShPKNJ P Shkup, botues i medias online – internet portalit "Skopje Info " (www.skopjeinfo.mk), t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për mospërmbushje të plotë të detyrimit sipas nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media, përkatësisht nuk i ka publikuar të dhënat për: emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emrin dhe mbiemrin e kryeredaktorit, përkatësisht redaktorëve në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar nr. 01-4241/1 datë 1.10.2025), urdhërohet që Shoqëria për shërbime IT, teknike dhe konsulence DMS Komunikim ShPKNJ P Shkup, botues i medias online-internet portalit "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk), në afat prej 20 ditësh nga data e pranimit të Aktvendimit për ndërmarrjen e masës, ta harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Mediat.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar të paralajmërimit publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk veproi), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 11

Udhëheqësja e Spektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, Magdalena D. Dovleva, informoi se botuesi i medias online-internet portalit "National" (www.nacionalno.mk), Shoqëria për media, tregti dhe shërbime N&M Media Group ShPKNJ P Shkup, është konstatuar dhe se ndërkohë ka bërë korigjime në impresium. Megjithatë, ajo theksoi se është gjetur shkelje gjatë mbikëqyrjes së kryer më 27 shkurt, prandaj ka bazë për veprim. Në këtë drejtim, ajo propozoi, në përputhje me Ligjin për Media, të shqiptohet masë paralajmërim publik.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr. 03-779/1 datë 27.2.2026 dhe njëzëri u konkludua që Shoqërisë për media, tregti dhe shërbime N&M Media Group ShPKNJ P Shkup, botues i medias online-internet portalit "Nacional" (www.nacionalno.mk), t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për mospërmbushje të plotë të detyrimit sipas nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media, përkatësisht nuk i ka

publikuar të dhënat për: adresën e selisë së botuesit të medias dhe emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar nr. 01-4241/1 datë 1.10.2025), urdhërohet që Shoqëria për media, tregti dhe shërbime N&M Media Group ShPKNJ P Shkup, botues i medias online-internet portalit "Nacional" (www.nacionalno.mk), në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për ndërmarrjen e masës paralajmërim publik, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar të paralajmërimit publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk veproi), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 12

Udhëheqësja e Spektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, Magdalena D. Dovleva, shpjegoi se bëhet fjalë për sigurimin e fondeve për përdorimin e shërbimit të sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror. Ajo theksoi se këtë shërbim Agjencia e ka përdorur për disa vite në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me Regjistrin Qendror dhe se e njëjta funksionon në parimin e parapagimit, përkatësisht me pagesë paraprake të një shume të caktuar mjetesh, me ç'rast për çdo shërbim të shfrytëzuar zvogëlohet shuma e disponueshme. Ajo shtoi se aktualisht ekziston nevoja për pagesë shtesë në mënyrë që të sigurohet funksionim papengesë të punës së Agjencisë. Shuma e propozuar e pagesës është 50.000,00 denarë, dhe informoi se 40.000,00 denarë janë paguar në janar 2025, me të cilat mjete janë përdorur pothuajse gjatë gjithë vitit. Ajo deklaroi se fondet për këtë qëllim janë parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2026.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, pyeti nëse kjo është pagesë që bëhet një herë në vit apo varet nga vëllimi i përdorimit të shërbimeve.

Udhëheqësja Dovleva shpjegoi se pagesa varet nga shpenzimet, përkatësisht kur fondet shterohen ose zvogëlohen në nivel të caktuar, kryhet pagesë e re.

Kryetari Stefanovski gjithashtu pyeti nëse pagesa e mëparshme i referohej vitit aktual, për të cilën udhëheqësja Dovleva sqaroi se ishte pagesë e bërë në janar 2025.

Këshilltarja Cvetanka Minovska kërkoi shpjegim më të detajuar në lidhje me destinimin konkret të fondeve, përkatësisht për cilat shërbime përdoret sistemi i shpërndarjes së internetit në Regjistrin Qendror.

Udhëheqësja Dovleva shpjegoi se përmes këtij sistemi më shpesh ofrohen gjendjet aktuale për transmetuesit dhe botuesit e mediave, ku çdo shërbim i tillë tarifohet. Ajo theksoi se sistemi përdoret edhe në procedurat për ndryshimin e strukturës pronësore, kur është e nevojshme të përcaktohet lidhja e pronarit të ri me shoqëri të tjera tregtare, si dhe gjatë procedurave për dhënien e lejeve, kur kryhen kontrolle mbi strukturën themeluese. Përveç

kësaj, sistemi përdoret edhe në procedurat kundërvajtëse, si dhe për nevoja të tjera të Agjencisë për sigurimin e të dhënave përkatëse.

Këshilltarja Afrona Vërzivoli shtroi pyeti nëse fondet nga pagesa e mëparshme prej 40.000,00 denarësh ishin shteruar plotësisht.

Udhëheqësja Dovleva u përgjigj se fondet nuk janë shfrytëzuar plotësisht dhe se, sipas vlerësimit të saj, aktualisht kanë mbetur rreth 4.000,00 denarë, duke vënë në dukje se shuma është e përafërt.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për pagesën e mjeteve për t'i mundësuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale qasje në të dhënat e Qendrës së Shpërndarjes së Internetit të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shumë prej 50.000,00 denarësh, me të cilin do të krijohen kushte për pëmbushjen e vazhdueshme të detyrimeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të parashikuara në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe në Ligjin për Mediat.

Pika 13

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për financa dhe logjistikë, Vesna Simonovska, shpjegoi propozimin për dhënie të miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit - shërbime artizanale, me vlerë nën pragjet për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Ajo shpjegoi se nevoja për këtë furnizim rrjedh nga defekti në njërin nga zyrat, si dhe nga nevoja për të zëvendësuar mekanizmat e dyerve të hyrjes në katin e tretë dhe të katërt të ndërtesës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për miratimin e burimeve financiare në shumën prej 26.695,00 denarë (31.500,00 denarë me TVSH), për furnizim me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike - për shërbime artizanale: riparim i dritareve (ndërrim mekanizmash) dhe instalim i amortizatorëve në dyert në katin e 3-të dhe të 4-ët.

Për realizimin e këtij shërbimi, fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026 .

Pika 14

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, sqaroi se bëhet fjalë për furnizim të shërbimi - mirëmbajtje të softuerit për sistemin për monitorimin e shërbimeve televizive dhe radio mbikëqyrjen e ORRPKE, i cili është parashikuar në Planin vjetor për furnizime publike, dhe fondet për zbatimin e tij janë siguruar në Planin Financiar për vitin 2026 dhe do të parashikohen shtesë në Planin Financiar për vitin 2027. Ajo theksoi se kontrata që do të rezultojë nga procedura e furnizimit publik do të lidhet për periudhë prej dy vitesh. Në përputhje me vlerën e parashikuar, procedura do të zhvillohet si procedurë e hapur, duke zbatuar dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Ajo sqaroi më tej se procedura do të fillojë me publikimin e njoftimi në sistemin elektronik të furnizime publike, në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në Gazetën Zyrtare të Unionit Evropian. Ajo theksoi se të gjitha informacionet relevante në lidhje me këtë pikë përbahen në materialet e dorëzuara anëtarëve të Këshillit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që drejtori i Agjencisë, për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtje e softuerit të sistemit për monitorimin e shërbimeve televizive dhe radio të ORRPKE.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën: mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit për monitorimin e shërbimeve televizive dhe radio dhe mbikëqyrja e ORRPKE, për periudhë prej 2 (dy) vitesh, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, përkatësisht ato do të sigurohen shtesë nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2027.

Pika 15

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se kjo procedurë e furnizimit publik është parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike, ndërsa fondet për zbatimin e saj janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026. Ajo theksoi se kontrata që rezulton nga kjo procedurë do të lidhet për periudhë prej një viti. Në përputhje me vlerën e parashikuar të furnizimit, ajo do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar, duke zbatuar dispozitat e Ligjit për furnizime publike që lidhen me këtë lloj procedure. Përveç kësaj, ajo sqaroi se procedura do të fillojë me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik të furnizimeve publike dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Ajo theksoi se të gjitha informacionet relevante përmbahen në materialet e paraqitura për këtë seancë.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, shtroi pyeti nëse kjo procedurë kryhet një herë në vit.

Udhëheqësja Mitrevska u përgjigj pozitivisht, duke shpjeguar se kontrata është lidhur për periudhë prej një viti.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli shtroi pyetje në lidhje me fondet e parashikuara për këtë furnizim.

Udhëheqësja Mitrevska informoi se për zbatimin e procedurës janë parashikuar mjete në vlerë prej 1.525.000,00 denarësh, duke përfshirë taksën e llogaritur të vlerës së shtuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbimi: mirëmbajtja e higjienës në ambientet e punës së Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: mirëmbajtja e higjienës në ambientet e punës së Agjencisë është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ndërsa fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, konstatoi se seanca është ndërprerë dhe njoftoi se do të vazhdojë me punë nga pika 16 në seancën e ardhshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**